



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 140, Datë 06.06.2022

MBI

**REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SUN BEAT SYSTEM” SH.P.K. PËR  
PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE  
NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2000 kW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma” a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenit 13 dhe 14, pika 2, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 866/1 prot., datë 02.06.2022, “Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë “SUN BEAT SYSTEM” sh.p.k., për tu licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2000 kW”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 84, datë 20.04.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SUN BEAT SYSTEM” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për një afat 25 vjeçar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje me shkresën nr. 70/11 prot., datë 22.04.2022, u bë njoftimi në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta (data 10.05.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 451/1 prot., datë 27.04.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë me “Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësim dokuemntacioni”.
- Për sa më sipër, dërguar nga ERE, rezulton se shoqëria “SUN BEAT SYSTEM” sh.p.k., nuk ka përcjellë asnjë përgjigje/shkresë.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar dhe fiskal

dhe Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe lejet nga institucionet respektive.

- Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “g”.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “d”.
  - Dokumentacioni teknik për centralin forovoltai - neni 9, pika 4.4.3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 4.4.4, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”.
  - Leje nga institucione të tjera - neni 9, pika 4.4.5, gërmat “a” dhe “b”.

Dokumentacioni i konstatuar i munguar është:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2:

- **gërma “d”** (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). **Shoqëria nuk ka depozituar vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë të Qarkut Korçë për administratorin dhe vetë shoqërinë duke qenë se ka seli vetëm në këtë qark.**
- **gërma “f”** (Marrëveshje Koncension apo çdo formë tjetër e marrëveshjes në rastet e aplikueshme të lidhur me institucionet përgjegjëse të ngarkuara me ligj, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës si dhe ndryshim të këtyre akteve.) **Shoqëria nuk ka depozituar dokumentacionin përkatës (marrëveshjen/kontratën me MIE-n), në vijim të miratimit të MIE-s nr. 1012/4 prot., datë 11.03.2022.**

Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3:

- **gërma “b”** (bilanci financiar i tre viteve të fundit / ose i kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit). **Shoqëria nuk ka depozituar pasqyrat financiare të vitit 2021.**
- **gërma “c”** (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj). **Dokumenti i depozituar nga shoqëria në kuadër të shprehjes së interesit nga banka gati përpara një viti, nuk është përcjellë në kuptim të rregullores me datë të rifreskuar dhe nuk është bërë me dije nëse është nënshkruar me bankën kontratë për të siguruar 80 % të investimit dhe as se si do të mbulojë 20 % të vlerës së investimit.**

Dokumentacioni tekniko-ekonomik. Neni 9, pika 4.1.4

**Shoqëria nuk ka plotësuar të dhënat për centralin prodhues dhe emrin e centralit, sipas kërkesave të formatit përkatës. Gjithashtu nuk ka bërë saktësimin në lidhje me Numrin e njësisive gjeneruese, dhe kapacitetin e sejcilës pasi nga të dhënat që ka përcjellë rezulton se 15 njësi x 175 kW është e barabartë me 2625 kW, çka kalon edhe kapacitetin prej 2000 kW, për të cilin kërkoni të licencohet.**

**Po ashtu, nuk ka saktësuar formatin e të dhënave teknike sa i përket datës së fillimit të operimit 04.04.2022, ndërkohë që aplikimi është paraqitur në po këtë datë në ERE. Të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin Neni 9, pika 4.4.2.**

**Shoqëria nuk ka plotësuar të dhënat për Skemën e lidhjes së pëstjellave, sipas kërkesave të formatit përkatës.**

- Shoqëria nuk ka përcjellë informacion në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit apo fazën në të cilën ndodhen si dhe nuk ka bërë një përcaktim të qartë të viteve brenda të cilëve do të ndërtohet projekti, në kuptim të zbatimit të grafikut të punimeve (pasi ky i fundit parashikon ndërtimin brenda një periudhe 24 mujore, por pa përcaktuar vitet konkrete).
- Duke qenë se nga dokumentacioni pronësor që subjekti ka depozituar në kuadër të licencimit, rezulton se numri i pasurisë së zonës ku do të shtrihet projekti është i ndryshëm nga ai i pasqyruar në VNM-në Paraprake, i është kërkuar shoqërisë që të bëjë saktësimin përkatës.
- Duke qenë se në aplikimin e shoqërisë “SUN BEAT SYSTEM” sh.p.k. mungon një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit, si dhe nisur nga fakti që kjo shoqëri, nuk ka përcjellë asnjë shkresë për plotësim dokumentacioni apo kërkesë për shtyrje të kësaj procedure, vlerësohet të refuzohet kërkesa e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “SUN BEAT SYSTEM” sh.p.k., për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2000 kW.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**